



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Ministarstvo za Rad i Socijalne Zaštite
Ministry of Labour and Social Welfare

Departamenti për Integrim European dhe Koordinim të Politikave

Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale edhe gjatë vitit 2013, nëpërmjet të gjitha politikave, programeve, dhe dokumenteve strategjike ka qenë e përkushtuar për fuqizimin dhe krijimin e hapësirës për mirëqenie sociale, krijimin e infrastrukturës për punësim dhe aftësim profesional, që do të ngritë cilësinë në ofrimin e shërbimeve për të gjithë qytetarët në gjendje të nevojës sociale. Është punuar edhe në legjislacion, mandej në fushën e luftimit të ekonomisë joformale si dhe në përkujdesjen e qytetarëve me nevoja të veçanta. Gjithashtu janë ofruar shërbime edhe për të gjitha kategoritë e pensionistëve në kuadër të legjislacionit në fuqi.

Avancimi kornizës ligjore nga fusha e punësimit dhe politikave sociale

Duke u mbështetur në rëndësinë e legjislacionit që ka për të gjitha fushat, veçmas për fushën e punësimit dhe çështjeve sociale, gjatë vitit 2013, MPMS-se, në pajtim me Programin Legjislativ të vitit 2013, ka hartuar dhe proceduar për shqyrtim në Kuvendin e Kosovës këto Projektligje: Ligji nr. 04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, i cili është miratuar dhe është shpallë në Gazetën Zyrtare nr. 22 e dt,16.06.2013; Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-019, për Aftësim ,Riaftësim dhe Punësimin e Personave me Atësi të Kufizuar, është miratuar në qeveri me dt. 27.12.2013; Projektligji për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, është miratuar në leximin e parë nga Kuvendi dhe gjendet në Komisione Parlamentare; Ligji nr. 04/L-205 për Agjencinë e Punësimit në Republikën e Kosovës është miratuar me dt. 12 dhjetor 2013, dhe është shpallë në Gazetën Zyrtare nr. 01 date 09.01.2014, ndërsa hyn në fuqi ne 1 janar 2015. Gjithashtu ne këtë vit është miratuar Rregullorja (QRK) nr. 30/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Punës dhe

Mirëqenies Sociale dhe është publikuar ne Gazetën Zyrtare të Republike së Kosovës me nr. GZ. 03/20, Janar 2014.

Përveç ligjeve të miratuara në Kuvend MPMS, ka përcjell në Qeverinë e Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim, Koncept dokumentin për Hartimin e Projektligjit për ndryshim dhe plotësim e Ligji për Këshillin Ekonomiko Social, si dhe Koncept dokumentin për Hartimin e Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për të Verbër.

Ndërsa Projektligji për ndryshim dhe plotësimin të Ligjit të Punës ka kaluar të gjitha procedurat e parapara, por nuk është dërguar për miratim në qeveri, pasi që i njëjti projektligj është bart në programin legjislativ për vitin 2014.

Përveç ligjeve të miratuara në Kuvend, dhe atyre të hartuara dhe të proceduara për shqyrtim në Qeverinë e Kosovës, janë miratuar edhe shtatëmbëdhjetë (17) akte nënligjore.

Sa i përket nismave strategjike, MPMS gjatë vitit 2013, në mënyrë të suksesshme ka përgatitur draftin e strategjisë sektoriale për punësim, mirëqenie dhe përfshirje sociale për vitet 2014-2020. Kjo strategji paraqet një përpjekje të MPMS-së për të punuar mbi një vizion dhe objektiva afatgjatë e të qëndrueshëm që prioritetizohen nëpërmjet një procesi sistematik dhe ndërtohen mbi mundësitë dhe shanset që jepen në mjedisin e përgjithshëm të Kosovës. Drafti i strategjisë tani me është përfunduar dhe pritet që deri në fund të muajit Janar 2014 të procedohet për aprovim në Qeveri, ndërsa në muajin shkurt 2014 do të fillohet me hartimin e Planit të Veprimit për Strategjinë Sektoriale 2014-2020.

Rritja e shkallës së punësimit dhe forcimi i trajnimeve profesionale sipas kërkesës së tregut të punës

Realizimi i politikave të punësimit dhe masat aktive të tregut të punës, edhe gjatë vitit 2013 ka vazhduar përmes shtatë (7) qendrave regjionale për punësim dhe njëzete tri (23) Zyra Komunale për Punësim. Gjatë kësaj periudhe raportuese është bërë regjistrimi i **16801** punëkërkuesve, prej tyre **7988** femra, janë ç’regjistruar **8320** punëkërkuesve, janë gjetur (incizuar) **6748** vende të lira të punës, ndërsa është ndërmjetësuar në punësim te **4512** punëkërkues, ndërkohë ka përfunduar edhe ndërtimi i dy Zyrave Komunale të Punësimit në Vushtrri dhe Drenas .

MPMS-ja, edhe këtë vit, në bashkëpunim të ngushtë me UNDP-në, LUX-Development-in, Zyrën e Bashkimit Europian (BE) në Prishtinë, Bankën Botërore, Aleancën Kosovare të Biznesit, MBPZhR, komunat e partnerë tjerë, ka zhvilluar një sërë projektesh, ku realizimin e këtyre projekteve janë angazhuar një numër i madh i punëkërkesve.

Vetëm në projektin e BE-së “Kosova e bukur” janë përfshirë, 509 punëkërkes prej Zyrave Komunale të Punësimit dhe 169 prej kompanive. Gjithësej 678 punëkërkes.



Pamje, nga projekti Kosova e Bukur

Në “Berza e Punësimit 2012”, projekt ky që realizohet në bashkëpunim me AKB-në, janë përfshirë në procesin e punësimit 445 punëkërkues.

Numri i përgjithshëm i punëkërkuesve të rinj të përfshirë në projektet e përbashkëta me partnerët e MPMS-së për vitin 2013 ka qenë 4.512 punëkërkues.

Me qëllim të gjetjes së punës më lehtë, MPMS përmes mekanizmave të vet, ka organizuar trajnime për punëkërkuesit. Gjatë këtij viti 2013, në trajnime janë përfshirë 3730 punëkërkues. Kurse nga Qendrat për Aftësi Profesionale, brenda kësaj periudhe janë certifikuar 2861 kandidat. Përmes projektit Kosvet VI deri në fund të shtatorit 2013 janë trajnuar në punë 1129 1416 kandidatë.

Për t’u ofruar kushte sa më të mira pune stafit dhe punëkërkuesve që trajnohen, gjatë vitit 2013 është ndërtuar dhe funksionalizuar një objekt modern për aftësim profesional, në Mitrovicë. **(Foto e objektit të Qendrës për Aftësi Profesionale ne Mitrovicë)**



- Qendra e Aftësimeve Profesionale ne Mitrovicë

Mbikëqyrja e dispozitave ligjore që rregullojnë lëmin e punës, punësimit, sigurisë në punë, dhe mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve

Në aspektin e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, Ligjit Nr. 04/L-161 për Siguri dhe Shëndet në Punë si dhe ligjeve dhe akteve tjera nënligjore, të cilat rregullojnë lëmin e punës, punësimit, sigurisë dhe shëndetit në punë, nga ana punëdhënësve dhe punëtorëve, Inspektorati i Punës në vazhdimësi ka inspektuar subjektet si në sektorin publik ashtu edhe në sektorin privat. Gjatë vitit 2013 janë kryer 8378 inspektime në subjekte punuese në të dy sektorët, (publik dhe privat), nga të cilat 5627 inspektime janë inspektime të rregullta. Vërejtje me shkrim janë shqiptuar ndaj 1712 subjekteve punuese. Duke u ndërlidhur me rezultatet e Inspektoratit të Punës në luftimin e ekonomisë jo formale, vlen të përmendet se është arritur të legalizohen 289 subjekte punuese, të cilat kishin ushtruar veprimtari pune pa e regjistruar biznesin si dhe janë formalizuar 3371 punëtor, të cilët kanë punuar pa kontrata të punës. Janë inspektuar 54 raste të aksidenteve në punë, në të cilat 17 punëtor kanë humbur jetën dhe 37 kanë pësuar lëndime të rënda. Poashtu MPMS, pas miratimit të Ligjit Nr. 04/L-161 për Siguri dhe Shëndet në Punë, me synim të sensibilizimit të punëdhënësve dhe punëtorëve, lidhur me obligimet dhe përgjegjësitë e tyre karshi ligjit, gjatë këtij viti ka organizuar fushatë mediale, por edhe takime të përbashkëta me punëdhënësit, përfaqësuesit e punëdhënësve, punëtorëve dhe përfaqësuesve të punëtorëve

Rritja e mirëqenies sociale përmes ofrimit të mbështetjes në komunitet dhe zvogëlimi i varfërisë

Në kuadër të përgjegjësive të veta MPMS, vazhdon përkushtimin ndaj qytetarëve me nevoja të veçanta pa dallime etnike, fetare, gjinore e racore, nga fëmijët e deri tek të moshuarit pa përkujdesje familjare.

MPMS ka vazhduar me ofrimin e shërbimeve për strehim familjar për fëmijë që nuk kanë lidhje farefisnore dhe realizimi i strehimit familjar të fëmijëve pa përkujdesje prindëror. Gjithashtu ka vazhduar zbatimin e skemës për mbështetje të familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme prej 1-18 vjet, ku kanë përfituar rreth 3069 fëmijë me nga 100 euro në muaj. Në fushën e anti trafikimit me qenie njerëzore, MPMS-ja është pjesë aktive kundër kësaj dukurie ku participon edhe me 50% të financimit të një strehimoreje që ofron përkujdesje dhe shërbime për mbrojtjen e këtyre viktimave. MPMS-ja gjithashtu, participon me 50% të mjeteve financiare për 6 shtëpi - strehimore regjionale, që ofrojnë strehim dhe mbrojtje të viktimave të dhunës në familje.

Përkujdesje institucionale 24 orësh kjo ministri ka ofruar për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara mendore për 260 rezidentë që ndodhen në Institutin Special në Shtime dhe në shtatë shtëpi me bazë në komunitet.

Përkujdesje e njëjtë është treguar edhe ndaj të moshuarve pa përkujdesje familjare në Shtëpinë për Persona të Moshuar në Prishtinë dhe në dy shtëpi me bazë në komunitet.

Në institucionet e lartcekura gjatë vitit 2013 ka pasur 21 vendosje të reja të kësaj kategorie.

MPMS ka ofruar ndihmë sociale për familjet që i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret që parashihen me aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë Skemën e Ndihmës Sociale. Në janar të vitit 2013 në SNS kanë qenë 31.333 familje, me 133.318 anëtarë të familjeve, në shumë prej 2,381,741.00 €, ndërsa në dhjetor të këtij viti në SNS kanë qenë 29.688 familje me 123,554 anëtar në shumë prej 1.924.017.00 €.

MPMS ka ofruar 220 ndihma emergjente, të cilat jepen për raste në situata të jashtëzakonshme (fatkeqësi natyrore, tërmete, vërshime, djegie të shtëpive, sëmundje-vdekje dhe tragjedi familjare). Për 220 familje janë dhënë 36,200 €.

Në bashkëpunim me MF-KEK-ut gjatë periudhës së parë të vitit 2013 është bërë subvencionimi i energjisë elektrike për vitin 2012 për 21.860 familje në SNS dhe 11.520 familje në Skemën e FDIL-ës. Nga të dy skemat janë subvencionuar gjithsej 33.380 në sasi mesatare prej 238 KËh apo 11.22 € në muaj.

Si pjesë e realizimit të projektit të financuar nga fondet e IPA-s të Komisionit Evropian, MPMS ka bashkëpunuar me OJQ-në One to One Kosova, për ofrimin e shërbimeve të fëmijëve me aftësi të kufizuar nëpër 5 qendra regjionale.

Krijimi i një sistemi pensional treshtyllësh i drejt, funksional me burime të qëndrueshme financiare, i cili plotëson kërkesat nga e drejta pensionale për të gjitha kategoritë e pensioneve.

MPMS, në kuadër të veprimtarisë së vetë, ka vazhduar suksesshëm operacionlaizimin e politikave të saj. Me këtë rast janë realizuar gjashtë skemat ekzistuese të pensioneve në Kosovë (Pensionet bazike, kontributeve, të aftësisë së kufizuar, të pensionistëve “Trepça”, atë të ish-pjesëtarëve të TMK-së dhe të FSK-së).

Në skemën e pensionit bazë, apo të pleqërisë, aktualisht janë **117.042** pensionistë. Shuma e paguar për këtë kategori ka qenë **87.340.090,00** euro.

Në skemën e pensioneve kontribut pagues janë **36015** pensionistë, kurse shuma për 2013 ka qenë **49.412.649,00** euro.

Numri i shfrytëzuesve të pensioneve për personat me aftësi të kufizuara është 18.891 persona. Shuma e paguar për këtë kategori ka qenë 14.272.440.00 euro.

Vlen të theksohet se vlera e pensioneve kontribut pagues nga 1 janari 2013 është ngritur në lartësi 40 %, ndërsa Pensionet Bazë dhe Pensionet e Aftësisë së Kufizuar nga 1 Janari 2013 janë ngritur në vlerën 33,3%.

Në skemën e pensioneve të parakohshme “Trepça” aktualisht janë 3.771 shfrytëzues. Shuma e paguar ka qenë 3.058.800 euro.

Numri i shfrytëzuesve të ish-pjesëtarëve të TMK-së është 798, kurse janë paguar 1.781.911.00 euro.

Për 103 ish-pjesëtarë të FSK-së janë paguar pensionet në vlerë prej 234.577 euro.

Gjatë vitit 2013, Grupi Punues për ripërtëritjen e marrëveshjeve sipas konventave të vazhdueshme ndërkombëtare të sigurimit pensional invalidor, ka zhvilluar negociata të vazhdueshme me zyrtarët kompetent të Maqedonisë dhe Malit të Zi.

Ndërkaq, pas një periudhe të negocimit dhe bashkëpunimit të ngushtë R.e Maqedonisë dhe R. E Malit të Zi, në këtë vit, janë nënshkruar dy marrëveshje në sferën e pensioneve. Këto marrëveshje konfirmojnë periudhat e sigurimit për realizimin e të drejtës në pension për të gjithë ata që kanë punuar në shtetin e Maqedonisë dhe Malit të Zi.

Gjithashtu, janë mbajtur takime të nivelit të lartë me Turqinë dhe Zvicrën për zgjerimin e bashkëpunimit të ndërsjellë, respektivisht për çështjen e pensioneve të ndërprera nga autoritetet zvicerane

Përkrahja e invalidëve, familjeve të dëshmorëve, veteranëve dhe kategorive tjera të luftës

Gjatë këtij vitit 2013 është bërë implementimi I ligjit nr.04/L-054 . Deri më 30.11.2013 te drejtën në pensione nga skema e DFDIL-së, e kanë realizuar gjithsej 13,183 përfitues . Shuma e mjeteve të shpenzuara për transfere në vitin 2013 është 30.433.048.73€

Është bërë pagesa e 7 OJQ-ve nga muaji janar deri ne dhjetor në shumën 106,800.00 €.

Të drejtën për rehabilitim në Banjën e Pejës , Kllokotit dhe banjen Nëna Naile e kanë realizuar 118 anëtarë të Familjeve të Dëshmorëve, 236 Invalidë të Luftës dhe 170 Veteranë, 94 ish të burgosur politik (gjithsej 618) në shumën 118,180 € € .

Përveç pensioneve përfituesit e skemës kanë realizuar edhe këto beneficione ;

Lirim nga shpenzimet e energjisë elektrike ne shumën 1,790,130.87€ për 11,519 familje për vitin 2012. Lirim nga shpenzimet e doganimit të veturave për 235 Invalidë të Luftës.